

PYETJET ME TE SHPESHTA (FAQ)

Thirrja për grante në kuadër të projektit “*Mëso të rivlerësosh. Mos shpërdoro!* – Advancing Gender-Responsive Circular Economy Models”
Nr. i referencës së thirrjes.: E-81317209



Zbatohet nga:



Pyetje – Përgjigje

1. A janë të pranueshme kostot e TVSH-së në këtë thirrje?

TVSh në këtë thirrje nuk njihet si kosto.

Përfituesi është i detyruar të ndjekë procedurat ligjore për përjashtimin nga TVSH-ja për blerjet e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga ky grant, në përputhje me Nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor në fuqi.

Nëse Përfituesi, pas ndjekjes së procedurës për përjashtim, pajiset me dokumentacionin përkatës (Certifikata e Regjistrimit të Projektit dhe/ose Certifikata e Përjashtimit nga TVSH), ai është i detyruar t’ia paraqesë furnitorëve të tij, për të siguruar lëshimin e faturave me TVSH 0% për mallrat/shërbimet e projektit.

Në rast se Përfituesi nuk aplikon për përjashtimin nga TVSH ose nuk ndjek procedurën e kërkuar nga autoritetet tatimore shqiptare, TVSH e paguar do të konsiderohet shpenzim i pafinancueshëm nga ky grant dhe do të mbetet barrë financiare e Përfituesit.

2. A përfshihet edhe raportimi financiar dhe narrativ në periudhën 4 mujore?

Raportimi financiar e narrativ i ndërmjetëm është brenda periudhës katër mujore, ndërsa raportimi final do të jetë pas periudhës katër mujore, por te gjitha shpenzimet, faturat,



likujdimet do të kryhen brenda periudhës 4 mujore, përjashtuar tatimin në burim apo pagesa të tjera të cilat do të listohen në kontratën e grantit.

3. A duhet të hapim një llogari të dedikuar bankare për këtë projekt?

Nuk është detyrim hapja e një numri të dedikuar të llogarise bankare, por mbajtja sipas standardeve të kontabilitetit në Republikën e Shqipërisë.

4. A lejohet të aplikojnë degët në Shqipëri të ojf-ve të huaja? A ka nevojë të dorëzohen pasqyrat financiare të audituara?

Të gjitha organizatat e regjistruara dhe që punojnë në zonën e shpërndarjes gjeografike të thirrjes (gjithë territori i Shqipërisë) janë eligible.

Pasqyrat financiare të audituara duhet të dorëzohen vetëm kur subjekti që aplikon gjendet në kushtet e dorëzimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

5. A lejohet që ne të paguajmë qira për një ambient që do mbahen pajisjet apo vendi ku do zhvillohet kjo sipërmarrje qarkulluese?

Qiraja si shpenzim në këtë rast nuk është shpenzim administrativ por që i shërben aktivitetit ndaj duhet të buxhetohet në kategorinë “Kosto të tjera, Shërbime”.

Që të njihet kjo kosto, planifikimi i saj duhet i argumentuar në kolonën e “justifikimit të koston” duke dhene detaje specifike të përdorimit të hapësirës për qëllime të projektit dhe të përmbushë kriteret e kostove të lejuara të listuara në udhëzuesin për grante.

6. Në rastin e Universiteteve si aplikant, si do të bëhen xhirimet financiare?

Menaxhimi financiar nga Universitetet bëhet sipas rregullave të menaxhimit financiar të brendshëm bazuar në Udhëzimin nr 10, datë 12.7.2024 “ Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” . Drejtoritë e Financës pranë Universiteteve e ndjekin këtë procedure.

7. Sa % e fondit total mund të përdoret për burimet njerëzore?

Në këtë thirrje, pesha që zënë shpenzimet e stafit kundrejt totalit të projektit nuk është e specifikuar dhe kufizuar. Pritet te tetajohet justifikimi se për çfarë i shërben zbatimit të projektit dhe që vlera e koston të jetë e arësyeshme kundrejt pozicionit të përcaktuar.



8. A do kenë përparësi ato ide që mund të zhvillohen si një biznes në të ardhmen e afërt dhe a do ketë ndonjë klauzolë që nëse një nismë ka sukses të ketë mbështetje të vazhdueshme nga ju që mos të lihet pastaj për shkak të mungesës së fondeve?

Idetë do të vlerësohen vetëm në bazë të kriterëve që janë të pasqyruar në udhëzuesin e aplikantëve për grante dhe kjo thirrje mbështet grante të cilat zbatohen brenda periudhës së përcaktuar në udhëzuesin për grante.

9. Duke qenë se TVSH nuk rimbursohet, a mund të blejmë lëndë të parë nga fermerët dhe xhirimet financiare të bëhen përmes llogarisë bankare të fermerit përkundrejt një faturë të thjeshtë tatimore të lëshuar nga fermeri?

Në cdo rast, që të njihen shpenzimet, faturat e lëshuara nga cdo furnizues mallrash apo shërbimesh duhet të jenë të njohura fiskalisht pavarësisht nga furnizuesi apo natyra e shërbimit që ai ofron.

10. A mund të aplikojnë rrjetet e ngritura dhe funksionale nga programe të tjera në Shqipëri?

Mund të aplikojnë nëse plotësojnë kriteret e aplikimit për aplikantët në pikën 6.3 në udhëzuesin për grante.

11. Në pikën 4 të udhëzuesit, Shtrirja gjeografike, janë përmendur bashki specifike si zona zbatimi. Ndërkohë ju na komunikuat që nuk ka përcaktime territori për zbatimin e projekteve. Mund ta qartësoni këtë çështje ju lutem?

Projekt propozimet mund të zbatohen në të gjitha bashkitë e territorit të Shqipërisë, dhe çdo bashki është e vlefshme. Bashkitë që janë përmendur në udhëzuesin e aplikantëve nxiten të aplikojnë por pa synim preferencial sic është nënvizuar në dokument. Aplikimet nga këto Bashki nuk marrin vlerësim shtesë sicc mund të shihet nga tabela e vlerësimit të granteve në udhëzuesin për grante.

12. Si do të bëhet rimbursimi (në cilin moment) i fondit për projektet fituese?

Rimbursimi do të ndjekë rregullat e kalimeve financiare të kategorisë “grante” nën kornizën e rregullave të Bashkimit Europian. Detajet specifike do të diktohen në kontratën e grantit.

13. Nëse organizata e ka selinë në Tiranë por punon në zonat të cilat ju keni përmendur tek udhëzuesi për aplikantet, a është eligible projekti?

Po, është e vlefshme, pavarësisht selisë në Tiranë, aktivitetet mund të zbatohen kudo në territorin e Shqipërisë.



14. A lejohet nën kontraktimi i shërbimeve të caktuara apo punësimi me kontratë shërbimi i personave vetëm për periudhën e kohëzgjatjes së projektit?

Në kategorinë e kostos “1. Burime Njerezore” do të kontraktohet stafi i cili do të punojë për projektin me kontrata sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Kontrata e shërbimit do të perdoret në kategorinë e kostos “5. Kosto të tjera, Shërbime”.

15. A duhet të realizohet gjatë 2025 apo mundet që ta nis në Janar-Prill të 2026 zbatimin e projektit?

Në udhëzuesin për aplikantët për jepet informacion mbi afalet kohore të aplikimit në këtë thirrje dhe zbatimit të projekteve të mbështetura financiarisht prej saj. Koha kur parashikohet lidhja e kontratës për grante është dhënë në udhëzues dhe marrëdhëniet për zbatimin e grantit fillojnë menjëherë me lidhjen e kontratës dhe kohëzgjatja është jo më shumë se 4 muaj.

16. A është e mundur që një organizatë të jetë aplikanti lider dhe të ketë një partner i cili është NVM, që ka përfituar nga një grant në dy vitet e fundit?

Thirrja nuk e ka detyrim bashkë aplikimin dhe partneritetin.

17. Përtej zgjidhjeve emergjente, a parashikohet dhe edukimi brenda familjes, ndërrmarjes apo subjektet që ndosin përditëmjedisin?

Aktivitetet e lejuara në këtë thirrje janë aktivitetet të cilat përshtaten me veprimtarinë e aplikantit duke u bazuar te kriteret e vlerësimit të thirrjes si dhe të kategorive të aktiviteteve të lejuara të publikuara në udhëzuesin e aplikantëve për grante.

18. A mund ta kemi prezantimin e shfaqur në sesionet e informimit?

Prezantimi gjendet në faqen eeb të qendrës EDEN, atje ku është publikuar thirrja dhe mund të aksesohet nga të gjithë.

19. A mundet nëpërmjet kësaj thirrje të mbulohen vetëm disa prej kostove të një projekti. Pra psh. 20K euro nga ju dhe 20-30K të tjera nga donatorë të tjerë? Apo duhet që mbështetja juaj të jetë 100%?

Projekt propozimet e aplikuar në këtë thirrje duhet të përmbushin formatet, qëllimet dhe kriteret e thirrjes të listuara në udhëzuesin e aplikantëve për grante. Vlerësimet do të kryhen sipas kriterëve të vlerësimit të prezantuara në udhëzues. Bashkë financimi nuk është kriter por gjithashtu nuk është i përjashtuar. Mbetet në dorën tuaj për të bashkërenduar projektin midis dy



ose me shumë donatorëve të ndryshëm. Rendësi në këtë rast ka justifikimi dhe qartësia e ndarjes së buxhetit dhe aktiviteteve midis donatorëve.

20. Barazia gjinore mund të jetë si projekt më vete apo duhet të jetë gjithnjë e lidhur me mjedisin?

Projekt propozimet do të vlerësohen në bazë të përputhjes me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe përgjigjshmërisë gjinore. Në këtë kuptim një projekt duhet të integrojë elementët gjinorë me elementët e ekonomisë qarkulluese. Pra projekt propozimet do kenë 2 shtylla kryesore: ndikimi në mjedis përmes konceptit të ekonomisë qarkulluese dhe ndikimi social përmes konceptit të përgjigjshmërisë gjinore. Format i aplikimit ja u dikton këto dy shtylla gjithashtu.

21. Unë jam si individ, a duhet të bashkëpunoj me një organizatë për të përfituar?

Në këtë thirrje nuk lejohet aplikimi si individ. Aplikimi mund të bëhet nga një organizatë jo fitimprurëse, universitet/qendër kërkimore ose NVM.

22. Po një grup pedagogësh mund të aplikojnë në një projekt pa bashkëpunim me OJF?

Mund të aplikoni nëpërmjet Universitetit apo një qendre kërkimore. Në këtë thirrje nuk lejohet aplikimi i individëve.

23. Në lidhje me aktivitetet, nëse realizojmë një hackathon dhe dy ide më të mira perzgjidhen. A është e lejueshme financimi i këtyre ideve?

Mirëpriten idetë inovatore dhe për hartimin dhe ideimin e konceptimin dhe aktiviteteve ju nuk keni kufizimi përveç listës së aktiviteteve jo të lejuara të udhëzuesit për aplikantët për grante.

24. A mund të fitojë 1 aplikues më shumë se një projekt?

Në këtë thirrje një aplikant mund të aplikojë me më shumë se 1 projekt ide, por një aplikant mund të përfitojë mbështetje financiare për vetëm një projekt ide.

25. A mundet që buxheti në një aplikim të jetë vetëm për blerje pajisjesh?

Ndërtimi i buxhetit duhet të jetë në përputhje me aktivitetet e projekt propozimit dhe të përfshijë kostit e lejuara dhe aktivitetet e lejuara sipas kritereve të listuara në udhëzimin e aplikantëve për grante. Si rrjedhojë, ndërtimi i buxhetit dhe zërat buxhetorë të nevojshëm janë specifik për secilën projekt ide.



Në këtë thirrje nuk mbulohen aktivitete që shpenzojnë më shumë se 40% të grantit për pajisje/infrastrukturë/furnizime pa një plan trajnimi dhe mirëmbajtjeje. Gjithashtu, cdo projekt ide duhet të ketë një ekip zbatimi të buxhetuar ose jo në kërkesën për grant të kësaj thirrjeje.

26. Kushti për minimumin 3 punonjës, nuk e plotësojmë dot dhe donim të dinim nëse numri 3 nënkupton numrin e punonjësve aktual të aplikantit?

Aplikantët duhet të kenë ekipe pune/staf të përbërë prej 3-25 anëtarë nënupton që në ekipin tuaj që do ngrihni për zbatimin e projektit dhe/ose në stafin e perhershëm të keni jo më pak se 3 anëtarë.

27. A është i detyrueshëm bashkë financimi?

Bashkëfinancimi nuk është detyrim në këtë thirrje.